

UNIVERSALJA NË PËRMBLEDHJEN POETIKE “GJEOMETRI DHE IKJE” TË ZEF SKIRO DI MAXHOS

Vebi BEXHETI¹, Valdeta DULAHU²

¹* Faculty of Language, Cultures and Communication, South East European University - Tetovo

^{*}Corresponding author e-mail: v.bexheti@seeu.edu.mk

Me shumësinë e temave që i trajtoi poeti Zef Di Maxho në poezinë e vet, nuk mungoi as ajo e karakterit universal, ku ai dëshiron të ikë nga ambienti ku jeton e vepron. Të këtilla lëvizjesh dhe shfrenimesh për ta gjetur frymëzimin poetik, edhe në vende të huaja, madje në thellësinë e historisë, hasim shpesh në krijimtarinë poetike, madje, që nga ajo më e hershmja e derinë këto më të vonshmet. Raportet e tij krijuese me Morenë, madje me letërsinë antike greke, ishin rezultat i kërkimit të rrënjëve të hershme të kulturës shqiptare, që shkojnë deri në kohën e Homerit dhe veprave të tij, Iliadës dhe Odiseut.

Në vargjet e shumë veprave poetike të këtij poeti, kjo lidhje me mitologjinë antike është në interes të ndërtimit të vargut me temë nga jeta e arbëreshëve dhe fatit të tyre që nga zhvendosjet e para nga atdheu i vjetër e deri në ditët e sotme. Zef Skiro Di Maxho, si poet që u krijua në frymën e kombit të “shprishur”, por që u ngrit si intelektual në shkollat italiane, pa u shkëputur për asnjë moment nga brenga për etninë arbëreshe dhe gjuhën e lashtë të këtij komuniteti, me kohë kishte dalë nga lëvozhga e ngushtë e rrethit ku jeton, për t’i njohur shqiptarët kudo që ndodhen ato, madje edhe hapësirat tjera evropiane, qytetet e bukura dhe banorët e tyre.

Këto ikje drejt botës, janë vet fatet e njeriut real dhe imagjativ të vet poetit, në kohën kur lëvizja e njerëzve nëpër botë po merr përmasë zhvillimi të hovshëm, në mesin e të cilëve edhe të shumë shqiptarëve, që sot mund t’i gjejmë në çdo cep të globit. Vepra poetike *Gjeometri dhe ikje (1998)* përfshin poezi, të frymëzuara nga shumë qytete të Evropës dhe jo vetëm. Në poezinë “Bukur është të shkruash “Dublin”, poeti duke folur për këtë qytet, spikat nevojën e daljes nga “lëvozhgë e pathyeshme e vezës”.

Edhe në këtë largim, qoftë imagjativ, poeti nuk i largohet personazhit të Odiseut, simbolit të largimit nga atdheu dhe harresës se duhet kthyer në vatrën familjare, që e sheh të shoqëruar me shkrimtarin e madh irlandez, Xhejms Xhojsin, që në këtë rast nuk i lidh bashkëkohësia por gjithësi romani i Xhojsit, “Uliksi” (Odiseu): *Ulur përpara një tavoline/ të një kafeje tipike dublineze shoh/ sa herë shkon për t’ikur/ nga lëvozhga e tij Odiseu/ bashkë me mikun Xhojsin/ duke shpurë “Dublinin brenda truve/ përtej deteve/ si peshë e fatit/ e si pendë.* Nga Dublini irlandez, poeti i afrohet Moresë historike.

Poezia “E dua Athinën”, është gjithashtu e lidhur me të kaluarën historike, prandaj poeti, që në fillim të poezisë vjen me vargjet: *E dua Athinën. Të vjetrën/ të ngrohtë me pasione origjinale*. Poeti frymëzimin poetik për qytetin e dikurshëm me shumë arvanitas, e gjeti kur ishte vet i pranishëm atje, prandaj edhe e njeh frymëmarrjen e tij, bashkë me banorët, në mesin e të cilëve edhe shumë zanatçi, me emrat e njohur të filozofëve të vjetër:

*Në Athinë vajta vërtet. Ku njoh njerëz
me emre të zakonshëm e zanate
të përditshme: Sofokliun, Aristofanin,
Sokratin, Aristotelin...sot shitës dhe mekanikë
dje poetë e filozofë.*

(Edua Athinën)

Edhe me vargjet në vijim, poeti Zef Di Maxho i afrohet historisë së hershme dhe fatit të arvanitasve, që sot në këtë qytet i gjen rrallë e më rrallë, madje, edhe ata që ende ndihen me gjak shqiptari, nuk e kanë guximin të deklarojnë si të tillë. Poeti, që e sodit qytetin nga hoteli, me sy kah Panteoni, sikur i sheh eshtrat e të parëve të tij të moçëm: *Nga Hoteli sodis lart Panteonin elektrik/ si bie mbrëmja: më duken eshtrat e shenjtë/ të Etërve tanë të përbashkët/ të zbardhur nga koha*. Pjesë e vargut të kësaj veprë të poetit arbëresh u bënë edhe kështjellat e Luarës, pranë Parisit, ku poeti nuk kishte qenë, por që këto kështjella i kishtenë kartolina, që mund t’i shohë saherë që të dojë, e që i krahason me ato shqiptare, që nuk e patën fatin si ato franceze, që të mbeten ashtu siç kanë qenë: *Të shijshme janë/ t’i përtyp rrjedhshëm Kështjellat e Luarës/ të mos shtyp ngaherë/ kështjellat e mia prej karte* (Kështjellat e Luarës).

Me poezinë “Kush s’ka qenë në Njujork”, poeti e bën krahasimin e një vendi të madh me një vend të vogël, siç është Hora e tij, që ka banorë sa një kat rrokaqielli të Njujorkut. Ai përmes vargjeve të kësaj poezie, nuk e fsheh mospajtimin që të jetojë në këtë qytet gjigant e përbindësh, ku çdo gjë është e madhe, madje edhe mendimi: *s’mund të jetoja në Njujork/ për faktin se kam thom unë-/ një mendim të vogël/ lindur të vogël rritur të vogël/ e aty në Nju Jork mendimi është bishë e përbindshme*. Nga shumë qytete, poeti në poezitë e kësaj përmbledhjeje poetike e radhit edhe Elbasanin, të cilin edhe pse e gjykon që në fillimin e saj, me titullin “Në pluhurin e Elbasanit” të poezisë, megjithatë dëshiron të jetojë aty, në këtë qytet të lashtë shqiptar, pranë godinave plot blözë, e tym industrial, dhe katranit të nikotinës, ulur në poltronën e vet, ku do flasë gjuhën e njëjtë me vendësit:

*takoj një bashkëkatundar e i them: Dëgjo,
këtu flasin si flasim ne matanë në Itali
e s’ka shije mos të të kuptojnë.
Dëshiroj e jam në Elbasan
të marr frymë borotalku industrial
dhe cigareje të fortë katrani e nikotine
ulur këtu në polithronën time.*

Edhe Voskopoja, ky katund afër Korçës, dikur qytet me një zhvillim të madh infrastrukturor, kulturor, arsimor e fatar, ishte gjithashtu destinacioni i udhëtimit të autorit. Ai konstatoi se ky vend ishte me vlera, që duhej ruajtur si shenja qytetërimi. Poeti ndalet te monumentet fetare të krishtera, flet për Shën Kollin, bëmiresin e fëmijëve, njëzet e pesë kishat, priftin, kandelierët, mesharin, dhe moskujdesjen e degradimin e këtyre vlerave: *Voskopoja rrëzuar nga dafinat/ mesjetare. Njëzet e pesë kisha./Të mos të përfitohej/ u bë gabimi më i trash* (Në Voskopoje u ndodha vërtet).

Edhe qyteti bregdetar Nafpaktos i Greqisë në kujtesën historike të poetit peshon rëndë, prandaj në vargjet e tij vjen me tërë lavdinë e arvanitasit, Marko Boçari: *Pllakë guri e fjalë lavdie/ ku u rrit Boçari./ Si në Greqinë e tërë/ më sulmon atyn ndjenja/ epike të gurëve/ që nami zmadhoi* (Kur vendos të jetoj në Nafpaktos). Zef Di Maxho edhe kur i përmend vendet më të largëta, siç është qyteti Kinez Lhasa, në përcaktim të vendit, ku dëshiron të bëhet kallogjer budist, dhe Tibeti e Himalaja, ai nuk lë pa e përmendur Horën e tij të vogël: *Ngjyra portokali Tibetan, më ka hije./ Në Lhasa jam kallogjer budist...në kanistrën e vogël Hora* (Në Lhasa jam kallogjer budist).

Edhe kur poetin tonë fantazia krijuese e çon në vendin ekuatorial të Zairesë, ai sërish merret me gjuhën shqipe, me fjalët njërrrokëshe të saj, madjeshqip i tingëllojnë edhe shprehjet pasthirmore të banorëve të qytetit të bimëve të këtij vendi. Përmes fjalëve me ngjyrim alegorik në këtë rast i godet të gjithë ata shqiptarë të vetëquajtur gjuhëtarë që mendojnë se e tërë bota flet shqip, madje, sipas tyre edhe shprehjet njërrrokëshe të banorëve "pigme", që duke vallëzuar rreth, zjarrit ku piqet një kofshë elefanti, vijnë nga shqipja: *si bëjmë ne me miqtë pigme/ rreth zjarrit që pjek/ një kofshë elefanti duke bërtitur "Ssa-bbu-kku-rr! Ssa-bbu-kku-rr!" / ritmikisht që më duken fjalë shqipe/ por s'jam i sigurt* (Sado që tingujt).

Aventurat virtuale të poetit nuk kanë të ndalur, madje atë e gjejmë edhe në ishujt vullkanik Galapagos, të Oqeanit paqësor, ku i zbulon gjarpërinjtë me pamje të njeriut të ardhshëm: *Megjithatë, në fizionominë/ e gjarpërinjve mund të shihet njeriu/ i ardhshëm. Disa që tani zbulohen:/ nofulla të hekurta sy helmues* (Në Galapagos). Edhe qytetin e bukur turistik dhe të veçantë, Venedikun, poeti e përshkruan, duke e soditur "në profilin, që i vizatojnë llambushkat" nga stolat e Lidos. Stambollin, këtë qytet metropol, që është ndër qendrat më të mëdha botërore turistike tregtare e kulturore, poeti e përshkruan si vendin ku përzihen të gjitha racat e kombet: *E kur të duash je grek o romak/ turk sicilian kur të duash/ anglosakson francez/ aq është shuma që rezultat jep/ Stambolli qytet* (Kam një vend të mendjes sime qytet).

Bashkë me qytetin e Izmirit e përmend edhe Homerin e Iliadës e Odisesë, vepra këto që shpeshherë bëhen pjesë e poezisë së mëparshme të Zef Skiro Di Maxhos (Në Izmir). Prishtina, kryeqendra e Kosovës, që në kohën e botimit të kësaj vepre poetike, ishte fjalë fëshfëritëse: *e fitilit që do të djegë barutin e gjithësisë*, për poetin megjithatë ishte shtëpia e tij, ku donte që edhe lulet, si: lulefëmijë, karafildjem, trëndafilevajza, lulediellinjerëz, të merrnin frymë të rehatshme. Përmes këtyre kompozita fjalësh, si zakonisht, vargu i poetit sjell risi, përveç tjerash edhe në aspektin gjuhësor. Poezia mbyllet me dy vargjet domethënëse, që e karakterizojnë Prishtinën e kohës, këtë qytet me agresorë dhe viktime: *...Ka gjithmonë kush tremb/ e kush rri i trembur. Në Prishtinë* (Prishtina është fjala).

Nga endjet e shumta nëpër qytete të ndryshme të botës, në një moment poetin e gjejmë edhe në portin e qytetit të Kadiksit në Spanjë, duke e prituri poetin arbëresh, lirikun e ëmbël, strigariotin, Zef Serembe, të kthehet nga Brazili në vendlindjen e vet. Me vargjet e poezisë "Pres në Portin e Kadiksit", poeti Zef Di Maxho shpreh dhembjen për Seremben, këtë poet, që pas udhëtimit të parë për në Brazil, ku ishte i ftuar nga Perandori Don Pedros, në vendlindje u kthye duarthatë pasi gjatë udhëtimit i kishin humbur shumë poezi: *menjë bagazh një trastë-varr të plotë/ me ëndrrat e vdekura të lavdisë. Zef Skiro Di maxho, si poet që është, e kishte njohur mirë jetën e Zefit tjetër poet, fuqinë magjike të lirikave të tij, që shumë më tepër do peshonin ndër arbëreshë: ...u gënjye të zinte rrënjë në plisa të reja/ kur ish lis që jep fryte/ po në kopshtin e shtëpisë.*

Gjatë këtyre bredhjeve nëpër vende e qytete të ndryshme, shumica të imagjinuara, poeti takohet edhe me personalitete letrare, siç është edhe poeti i madh, Virgjili, shpirti i të cilit kishte lënë gjurmë në ikje "sipër detit të Brindizit", me dëshirën që t'i digjen vargjet e poemës, mbase më lehtë do fluturonin me frymën e tij: *E vdes me iluzionin se fjalët e djegura/ fluturojnë me frymën e tij./ si psherëtimë deti, /si puthje flladi të qiellit* (Edhe duken vijat e ikjes), vargje këto, që janë të frymëzuara nga vepra madhore e Virgjilit, që shprehin fuqishëm emocionet e poetit

përartin e madh të tij letrar dhe përjetësinë, mbase tanimë fjalët e djegura do u takojnë të gjithëve, se do fluturojnë bashkë me frymën e Vigjilit dhe ashtu si dy bashkudhëtarë: “do u takojnë të gjithëve”.

Siç shihet, Zef Di Maxho me gjuhë aq të bukur poetike, ku spikasin metafora, krahasimi e figura tjera stilistike, e ngre në qiell poemën madhështore ”Eneida”, të Virgjilit, bashkë me autorin, që mbeten të pavdekshëm në historinë e letërsisë botërore. Gjurmëve të bëmirëses, nënës së madhe shqiptare, Shën Nënë Terezëz, që një jetë e sakrifikoi për t’u ndihmuar të tjerëve, autori mbërrini edhe në Kalkutë, ku e gjeti nxënësen e saj, prej të cilës do mësojë dashurinë për të afërmit, për qelbësirën e plagëve dhe botën fekale të rrugicave, ku vuanin njerëzit, duke e pritur vdekjen e sigurt. Për këto vargje, kushtuar Nënës së botës pa kufi, poeti shprehet se i shkruan në rrethoren e tij aseptike: ...*Për një botë pa kufij/ dashurie është nënë Tereza thelbësore/ dhe unë shkruaj këto vargje/ në rrethoren time aseptike* (Ndonjëherë thua partiturë).

Ciklin e dytë ”**Drama e ikjeve**”, të kësaj përmbledhjeje, poeti e hap me poezinë “Shqiptarë”. Pas një endjeje nëpër vende të ndryshme të botës, ku poeti gjente terrene të pakufizuara frymëzimesh, atë sërish e gjejmë mes shqiptarësh, me të njëjtat halle e vuajtjesh, në kërkim të shpëtimit diku tjetër, larg atdheut. Këtë atmosferë çrregullimesh në familjet shqiptare, poeti e paraqet përmes simbolikës së shtrëngatës, që shkatërron çdo gjë që i del përpara, duke hyrë brenda shtëpive: *furia e erës hyn në shtëpinë e hapur verës/ ngre perdet, një re letrash/ bën të dridhen shkëndijat në vathët*.

E tërë kjo tronditje është metafora e ikjes së përditshme të shqiptarëve nga cikloni shkatërrues. Detarin dhe jetën e tij mes dy kaltërsive, dhe dallgëve, që i sfidojnë edhe anijet, nuk e trembin këtë detar e udhëtar të përherëshëm: *Një rrotë jeta ime/ që nuk qëndronkurrë*. (Detar i vjetër). Dhe sërish anijet klandestine me njerëz në ikje, që nuk e presin ankurimin në portin, që i pret: *Pra numërimi i të mbyturve/ që mbyllën jetën e tyre të shtirë/ në gjirin blu-zi të detit të vërtetë/ pa shijuar edhe një cast/ të jetës normale njerëzore*. Në këto rrethana me erë vdekjeje, edhe ngjyra blu e detit, merr ngjyrë të zezë (Kam pritur ankorimin). Këto tragjedi, që vijnë nga deti, e që Zef Di Mxho i metaforizon përmes “argshit”(trinës) të shpëtimit, një ditë duhet të marrin fund, shpresë kjo edhe e autorit të këtyre vargjeve:

*E megjithate jam i bindur se në mbarim
kthjellim nga tragjedia do të vijë
sidomos për pafajësinë
treguar hapur në çdo port
të fëmijëve të tu të ëmbël.*

(E megjithate)

Shpërnguljen e madhe të shqiptarëve, nga atdheu, në drejtim të Evropës dhe shteteve tejoqeanike, vende këto, ku emigrantët e kohës së re, janë të sigurt se do e gjejnë parajsën, janë tepër shqetësuese për poetin. Ai përmes vargjeve të thella poetike, vjen me kuptime metaforike edhe për këtë dehje dhe lakmi për “parajsën” që i pret këta njerëz që dita-ditës e zbrazin vendin e vet. Këtë shtegtim masiv të njerëzve, poeti e paraqet si një dukuri kataklizme, kur këtij ekzodi i bashkangjiten malet, ”lumejt e fryrënga dehja e jetës së bukur përendimore”, rrënjët e degët, toka megjithë varre, ura e kulla. Ky proces, e gëlltit edhe atdheun, bashkë me tokën, e çdo gjë tjetër që jep jetë e gjallëri, mbase në një hapësirë të këtillë boshe, edhe shqiponjat do bëjnë jetë pulash, ndërsa e kotë dhe e pakuptimtë do jetë edhe poezia.

*E shqiponjat do të birësojnë qiej të vegjël
të vrenjtë nga smogu se preferuan
për të mbijetuar*

*një jetë pulash shtëpiake.
E kotë poezia si flet e këputur
rri në ujërat që shënojnë
kufijt e rinj të padukshëm.*

(Do të zmolen të vijnë)

Fenomenin e ikjes detare, poeti e sjell edhe në poezinë “Ti Qëndis”, ku me shumëllajshmëri vargësh flet edhe për poezinë, që qëndis emrat e Irsidave, Eriseldave, Entelave, Arlindave e Berlindave, emra këto shumë të shpeshtë në antroponimet shqiptare, të kohës së re. Në mesin e shumë të tjerëve që ia mësyjnë detit edhe këto vajza të: *hijshme thujse nxjerrë/ nga vargjet e Hmerit*, dëshirojnë të rimëkëmbin besën në tjera vende, edhe pse poetin ende e mban shpresa e vjetër: *Me të gjitha këto kontradikta/ me gjithë valljet vdekje-ringjalljeje/ ne mbajmë shpresë të vjetër*. Edhe poezia “Kartolinë nga Solunto” flet për ankorimet e anijeve plot refugjatë, njerëz fatkeq, por gjithmonë me dinjitet e krenarë për prejardhjen e tyre malësore. Kjo është pasqyra e brigjeve të vjetra e ankorimeve të reja, e thotë autori: *por krenare-me krenari malësore thom unë-/ kontradiktë te kërkesa e strehimit/ dhe dinjiteti-i motivuatr-/ të mos të ndihen të përulur* (Kartolinë nga Solunto).

Në ciklin e fundit **Gjeometri**, poeti Zef Di Maxho, i rikthehet Horës së tij dhe rrugës “Krispi”, i motivuar dhe nostalgjik për mjedisin ku lindi e u rrit dhe për kohën e kaluar, me shtëpitë e mbushura me arbëreshë, shumë nga të cilët i lanë vatrat të zbrazura duke marrë botën në sy. Këtë heshtje varri të shtëpive mbetur shkretë, poeti e përshkruan ashtu të vetmuar, me një tufë të egër carankthi, me dyer e dritare të mbyllura dhe me nënçatinë, me dy pëllumbat e dashuruar brenda. Këtë qetësi nuk e prishin as hapat e një plaku të rënë nga mosha. E vetmja zhurmë që e prish këtë heshtje e monotoni, është rënia e këmbanës, lajmëtares se në atë shtëpi u ndal edhe fryma e fundit: *Paradokse është rënia e këmbanëve/ që për një çast/ bën gazmore këtë rrugë Krispi* (La’(lalaK).

Vargjet e kësaj poezie janë të thjeshta e plot dhembje, që reflektojnë frymë të ngrohtë lirike dhe amosferë vetmie e braktisjeje. Një personazh tjetër lirik, të cilin poeti e bën pjesë të vargut të vet, është edhe LA’Dh., gjithashtu banor i rrugës “Krispi”, që shëtit rrugës së heshtur, ashtu i qetë, “me syzet e reja, që ia zmadhojnë sytë”: *Ndoshta të shihje më mirë ku/ të mbështetjeje këmbët sipër katranit të vjetër/ të kësaj rruge Krispi* (La ‘Dh). Në përmbledhjen poetike “Gjeometri dhe ikje”, poeti pa u shkëputur nga tema e tij e preferuar, për arbëreshët dhe fatin e tyre, na sjell edhe poezi me temë universale, që dëshmon edhe aspektin universal të krijimtarisë poetike.

Referencat

- [1]. Zef Skiro Di Mxho, Gjeometri dhe ikje, Palermo 1998
- [2]. Anton N. Berisha, Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë, Kozencë 2008
- [3]. Gjuha dhe letërsia e arbëreshëve (Përmbledhje kumtesash nga Simpoziumi Ndërkombëtar për Arbëreshët,, Tetovë 2011
- [4]. Vebi Bexheti, Studime arbëreshe, Tetovë 2020